



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 83, Datë 06.04.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SH.P.K NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGISJË ELEKTRIKE NGA HEC “VOSKOPOJË” ME FUQI  
TOTALE TË INSTALUAR 1970 KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “a”, 39 pika 3 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Voskopojë” me fuqi totale të instaluar 1970 KW,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën me nr.182 Prot, datë 15.02.2018, shoqëria “Favina 1” sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Voskopojë” me fuqi totale të instaluar 1970 KW.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 49 datë 07.03.2018 vendosi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Voskopojë”. me fuqi totale të instaluar 1970 KW.
- Në vijim të këtij vendimi, ERE në zbatim të nenit 19 pika 2, të “Rregullave Organizimit dhe Procedurave të ERE-s” dhe nenit 10, pika 8 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e

*Energjisë Elektrike* “, në datat 09 dhe 10.03.2018, publikoi në median e shkruar njoftimin lidhur me aplikimin e bërë nga ky subjekt.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 39, pika 3, të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “Voskopojë”.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 69, datë 21.12.2007, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 79, datë 23.10.2009, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 153, datë 12.11.2012, shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k, është licensuar në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga 25 Hec – e vendore (ekzistues), ndër të cilët dhe Hec “Voskopojë”, me fuqi të instaluar 400 KW.
- Me VKM nr. 930, datë 02.10.2009, nga lista e 25 Hec – e vendore në licencën e shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k, janë hequr Hec-et “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë”.
- Në vijim të VKM nr. 930, datë 02.10.2009, ERE është shprehur me vendimin nr. 161, datë 06.10.2016, “Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “Balkan Green Energy“ sh.p.k, me nr.3 Seria PV03K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 69, datë 12.12.2007“.
- Hec “Voskopojë ” rezulton në pronësi të shoqërisë “Favina 1“ sh.p.k., vërtetuar nëpërmjet aktit të shitblerjes nr. 4952 Prot, nr. 4040 Kol, datë 27.12.2015, me çertifikatë pronësie (dublikatë), nr. 1062411, datë 23.06.2015, lëshuar nga ZRPP Korçë.

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Voskopojë” me fuqi të instaluar 1970 KW, për një afat 30 (tridhjet) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.